



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Skrapar, më 08.09.2022

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË NË SHËRBIMIN CIVIL PËR NIVELIN E ULËT DREJTUES (PËRGJEGJËS SEKTORI)**

***Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike ”  
niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”***

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kreut II dhe III të Vendimit nr.242 datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar Bashkia Berat shpall procedurat e lëvizjes paralele , ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil për pozicionin :

- ***1(një) Përgjegjëse e Tatim Taksave , në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar, Buxhetit , Tatim Taksave, Kategoria e pagës III-a.***

*Plotësimi i pozicionit më sipër bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele .Pozicioni i lartpërmendur iu ofrohen fillimisht nëpunësve civil të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele.*

*Vetëm në rast se për këtë pozicion në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele rezulton se vendi është përsëri vakant, pozicioni është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë*

***Për të dyja procedurat: lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë aplikohet në të njëjtën kohë!***

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LËVIZJEN PARALELE

DO TË JETË

**22.09.2022**

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR NGRITJE NË DETYRË DO TË JETË

**29.09.2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR**

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Skrapar, më 08.09.2022**

### **PËRSHKRIMI I PERGJITHSHËM I PUNËS**

- Është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punës në sektorin përkatës.
- Është anëtar i Strukturës Vendore të Apelimit Tatimor në Bashkinë Skrapar dhe zbaton rregulloren e kësaj strukture
- Është përgjegjës për përgatitjen e parashikimeve mbi të ardhurat vjetore nga taksat dhe tarifat vendore, të cilin e çon për miratim tek Drejtori i Ekonomisë, Financave, Tatim Taksave dhe Shërbimeve.
- Është përgjegjës për përgatitjen e planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për çdo njësi administrative
- Propozon tek Drejtori i Ekonomisë, Financave, Tatim Taksave dhe Shërbimeve masa për mosrealizimin e të ardhurave që mund të jenë strategjike apo edhe individuale për vartës të drejtëpërdrejtë të sektorit që ai drejton.
- Propozon dhe paraqet tek Drejtori i Ekonomisë, Financave, Tatim Taksave dhe Shërbimeve projekt-urdhëra apo projekt-vendime në fushën e të ardhurave.
- Është përgjegjës për krijimin e regjistrit për evidentimin dhe licensimin e të gjitha subjekteve tregtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Bashkinë Skrapar.
- Kryen raporte muajore, 3, 6 apo 12 muajore apo edhe analiza mbi ecurinë e punës në sektor si dhe për realizimin e të ardhurave për çdo taksë apo tarifë në çdo njësi administrative apo përmbledhëse në tërësi për bashkinë.
- Evidenton dhe mban përgjegjësi për subjektet debitore si dhe ndërmerr hapa për mbledhjen e të ardhurave nga këto subjekte
- Raporton mbi baza mujore përpara Drejtorit për realizimin e të ardhurave për çdo taksë ose tarifë vendore dhe është përgjegjës për mos realizimin e tyre.
- Kontrollon mënyrën e llogaritjes së detyrimeve përkatëse për çdo subjekt tregtar në Regjistrin Vendor.
- Është përgjegjës për kryerjen e akt-rakordimeve me strukturat përkatëse të Bashkisë dhe agentëve tatimor, të cilat i paraqit më pas për miratim pranë Drejtorit të Ekonomisë, Financave Tatim Taksave dhe Shërbimeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR**

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Skrapar, më 08.09.2022**

-Bashkëpunon me përgjegjësat e sektorëve të tjerë të drejtorisë duke shkëmbyer informacion ndërmjet tyre.

-Kujdeset për mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit në lidhje me çdo subjekt që shlyen detyrimet, duke kontrolluar plotësimin e dosjes për çdo subjekt me dokumentacion të rregullt konform Vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-Është përgjegjës për mënyrën e llogaritjes së detyrimeve për taksat dhe mban përgjegjësi në rast se konstatohen gabime apo shkelje.

-Raporton mbi numrin e subjekteve debitoare dhe përgatit akt-detyrimet përkatëse.

-Përpunon informacionin në lidhje me subjektet dhe u'a jep për ndjekje, inspektorëve.

-Është përgjegjës për llogaritjen dhe printimin e akt-detyrimeve.

-Jep informacion ditore pranë Drejtorit lidhur me pagesat e detyrimeve nga subjektet dhe numrin e debitorëve.

-Ndjek hartimin e projekt buxhetit në tërësinë e elementëve të tij.

-Kontrollon me saktësi të gjitha arkëtimet që rrjedhin nga taksat dhe nga tarifat të cilat derdhen nga subjektet.

-Kryen kontabilizimin ditor të urdhërpagesave (pasi ka marrë postën e thesarit) në ditarin e bankës.

-Kryen plotësimet e dokumentave të bankës për arkëtimet në lidhje me pagesat duke i kryqëzuar ato me dokumentat përkatëse.

-Përpilon urdhër-pagesën, urdhër-xhirimin, pasi ka kontrolluar më parë dokumentacionin shoqërues.

-Në rastet kur nevojitet kryen dhe verifikime në terren.

-Ndjek duke respektuar afatet çdo korrespondencë me organe eprore, vartëse, institucione, individë, biznese, shoqata etj, që kryejnë veprimtari tregtare apo kërkojnë informacione që kërkojnë nga ky sektor.

-Bën vlerësimin e punonjësve të varësisë sektoriale dhe propozon tek drejtori elementë të nxitjes së performancës në punë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Skrapar, më 08.09.2022

-Është përgjegjës për kthimet në afat të përgjigjeve për kërkesat e shërbimeve OneStopShop që i adresohen sektorit.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori ,Kategoria III-a
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Kandidatët të zotërojnë Diplome Universitare të nivelit / **Master Shkencor** sipas legjislacionit të arsimit të lartë në , **Shkenca Ekonomike**, si diploma Bachelor edhe ajo master shkencor duhet të jenë në të njëjtën fushë . *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

- Përvojë pune **5 vite** në administratën shtetërore dhe/ose institucionet e pavarura dhe/ose institucionet e Qeverisjes Vendore
- Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Mbajtësi i këtij pozicioni duhet të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grupe.

### 1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrimi plotësuar nëpërputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Aktin e Statusit të Nëpunësit Civil
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR**

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Skrapar, më 08.09.2022**

- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Certifikata për gjuhën e huaj
- h- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore (deshmi penale),
- i- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- j- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- k- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë në sekretarinë e Bashkisë ose në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Skrapar, brenda dates **22.09.2022**

### **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **24.09.2022** Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Skrapar do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë si edhe në stendën e Informimit të Publikut , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista e strukturuar me gojë

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit , nëpërmjet email-it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

### **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si edhe Aktet nën ligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil
- Njohuritë mbi ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR**

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Skrapar, më 08.09.2022**

- Njohuritë mbi ligjin nr 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 68/2017 “Për financat dhe vetëqeverisjen vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemimin e taksave vendore” i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin nr. Nr. 122/2020 “ Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 Për sistemimin e taksave vendore” i ndryshuar.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 111/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 92/2014 Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

## **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR**  
**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

Skrapar, më 08.09.2022

*Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm.*

**1.6**

**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Skrapar do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë, Agjensinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe në **stendën e informimit të publikut**. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

**2**

**NGRITJA NË DETYRË**

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë*

**2.1**

**KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:**

- a- Të jetë nëpunës civil I konfirmuar;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës përnjehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR**  
**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Skrapar, më 08.09.2022**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

Kandidatët të zotërojnë Diplome Universitare të nivelit / **Master Shkencor** sipas legjislacionit të arsimit të lartë, **në Shkenca ekonomike**, si diploma Bachelor edhe ajo master shkencor duhet të jenë në të njëjtën fushë . (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohur papraprakisht pranë institucionit përgjegjës përnjehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).

- Përvojë pune **5 vite** në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e Qeverisjes Vendore
- Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Mbajtësi i këtij pozicioni duhet të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grupe.

**2.2 DOKUMENTECIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- Jetëshkrim I plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- Aktin e Statusit të Nëpunësit Civil
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjëndjes gjyqësore (deshmi penale),
- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- Certifikata për gjuhën e huaj
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët duhet të dorëzojnë me postën në sekretarinë e Bashkisë Skrapar ose në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Skrapar Brenda dates **29.09.2022** .

**2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR**

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Skrapar, më 08.09.2022**

Duke filluar nga data 01.10.2022 Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Skrapar do të shpallë në Faqjen Zyrtare, Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe në stendën e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e veçanta dhe kushtet e për ngritje në detyrë për Kategorinë e Ulët Drejtuese, , si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për ngritje në detyrë do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Bashkisë Berat, nëpërmjet email-it të tyre, për shkaqet e moskualifikimit.

**2.4**

#### **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” si edhe Aktet nën ligjore qe rregullojnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil
- Njohuritë mbi ligjin nr.139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 68/2017 “Për financat dhe vetëqeverisjen vendore” Njohuritë mbi ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemimin e taksave vendore” i ndryshuar
- Njohuritë mbi ligjin nr. Nr. 122/2020 “ Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 Për sistemimin e taksave vendore” i ndryshuar.
- Njohuritë mbi ligjin Nr. 111/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 92/2014 Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

#### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR**

**NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

**Skrapar, më 08.09.2022**

## **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Vlerësimin me shkrim, derinë 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike

**Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm .**

## **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Skrapar do të shpallë fituesin në portalin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Faqjen Zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

**BASHKIA SKRAPAR**